

# Ndihma Dhe Perkujdesja në shtëpi SPITEX-I

## KUJT DUHET TI DREJTOHEM NËSE KEMI NEVOJË PËR NDIHMË NË PUNËT SHTËPIAKE OSE PËR PËRKUJDESJE NË SHTËPI?

Persona të kualifikuar në këtë profesion i mbështesin dhe përkujdesen për pacientët e të gjitha moshave të cilët kanë nevojë për kujdesë dhe mbikqyrje në shtëpi. Spitexi i ndihmon familjarëve që perkujdesen për të afërmit e tyre në nevojë.

### ÇKA BËN SPITEXI?

Për në Spitex mund te bëjnë kërkësë përsonat që kanë sëmundje trupore dhe mendore, pleqët qe kanë nevojë per kujdes, të aksidentuar, nënënat pas lindjes dhe në rast të komplikimeve gjatë shtatëzanisë.

Shërbimet e Spitexit përfshijnë:

#### Përkujdesje në shtëpinë tuaj:

- Sqarime dhe këshilla për kujdesin mjekësor
- Këshilla për ofertat mjekësore
- Ndihmë në mirëmbajtjen e trupit
- Ndihmë gjatë lëvizjeve në shtratë (mobilizim)
- Përgaditja dhe administrimi i medikamenteve
- Vizita mjekësore sic janë, sëmundja e sheqerit (diabeti) dhe shtypja e gjakut si dhe të tjera
- Trajtimi dhe parandalimi i dhimbjeve
- Shërimi dhe pastrimi i plagëve
- Përcjellja e të vdekurve

#### Ndihmë në punët shtëpiake:

- Mbështetje gjatë pazarit
- Pastrimi i shtëpisë
- Larja e rrobave
- Gatimi

#### Sipas Rajonit Spiteksi orfon dhe:

- Shujta të ushqimeve (shërbimi i ushqimit)
- Vozitje dhe shoqërim tek mjeku ose për blerje
- Dhënje me qera e objekteve ndihmëse (paterica, aparate për inhalim dhe karrocë për invalidë)


Shërbime të tjera por që kryesisht ofrohen nëper qytete janë: trajtim psikiatrik, kujdes mjekësor në rastë kanceri ose të sëmundjeve tjera të pashërueshme.

Me mbështetjen profesionale dhe financiare të migesplus



www.migesplus.ch

Informacione shëndetësore në shumë gjuhë



### ÇKA PAGUAN SIGURIMI SHËNDETËSOR?

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor paguan shërbime mjekësore, mirëpo për këtë nevoitet një koordinim ose mirëkuptim në mes të Spitex-it dhe mjekut.

### ÇKA NUK PAGUAN SIGURIMI SHËNDETËSOR?

Ndihma në punët e shtëpisë nuk paguhet nga sigurimi bazë i sigurimit shëndetësor. Për këto arsyet në shumë sigurime shëndetësore mund ta zgjidhni një sigurim shëndetësor mbrenda sigurimit bazë. Per më shumë informacione kontaktoni sigurimin tuaj shëndetësor. Nese ju përfiton ndihma nga shteti dhe nuk keni mundësi për pagimin e shërbimeve, atëherë një pjesë të pagesës e paguan bashkia (komuna).

### ÇKA DUHET TË PAGUAJ KLIENTI?

- Shuma vjetore e sigurimit shëndetësor
- 10 % e shpenzimeve të shërbimeve mjekësore (pagesa vetanake e sigurimit shëndetësor)
- Pjesëmarrje e pacientint në pagimin e shërbimeve mjekësore (shuma mbi 15.95 CHF në ditë sipas kantonit)
- Shpenzimet gjatë ndihmës në punët e shtëpisë

#### Spiteksi ndodhet në çdo rajon të Zvicrës:

- [www.spitex.ch](http://www.spitex.ch) → Spiteksi në zonën tuaj
- Telefon 0842 80 40 20 (8 Rapë/Minutë)
- Administratë komunale ne vendëbanimin tuaj



**S P I T E X**  
Hilfe und Pflege zu Hause